



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR

Nr. 763/ , prot, Datë 12.4 2016  
2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I STOMATOLOGUT SHQIPTAR

Nr. 131 , prot, Datë 30.05 2016

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### MIDIS

#### INSPEKTORATIT SHTETËROR SHËNDETËSOR DHE PRESIDENTIT TË URDHRI TË STOMATOLOGËVE TË SHQIPËRISË

Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Presidenti i Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë (në vijim të quajtura “Palët”)

*Duke vlerësuar* rëndësinë e ushtrimit të profesionit të stomatologut në mënyrë sa më korrekte dhe në shërbim të plotë të pacientëve dhe të publikut,

*Duke konsideruar* si një ndër objektivat prioritarë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, zbatimin e kuadrit ligjor me qëllim përmirësimin e standarteve të larta profesionale tek mjekët stomatologë në të gjithë vendin, dhe zbatimin e angazhimeve reciproke për arritjen e këtij qëllimi,

*Duke afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

*Duke u mbështetur* në kuadrin e plotë ligjor që normon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 8615, ligjin nr. 9928, date 09.06.2008 "Për shërbimin stomatologjik në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Stomatologëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 10171 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimit stomatologjik,

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “*Memorandumi*”).

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i memorandumit është bashkëpunimi midis dy institucioneve për garantimin e respektimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon ofrimin e shërbimit stomatologjik sipas

legislacionit në fuqi, nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve të përbashkëta si dhe shkëmbimit të informacionit.

## **Neni 2** **Forma e bashkëpunimit**

1. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:
  - a. ngritjes së grupeve të përbashkëta të inspektimeve
  - b. shkëmbimit të informacioneve reciproke në funksion të efikasitetit të inspektimit të kërkesave ligjore që rregullojnë shërbimin stomatologjik në institucionet publike dhe jopublike
  - c. ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për ndreqjen e mangësive të konstatuara gjatë ushtrimit të inspektimeve të përbashkëta

## **Neni 3** **Angazhimet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor**

1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor përmes strukturës së tij merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:
  - a. Të mos lejojë ushtrimin e profesionit të Stomatologut në institucionet e kujdesit shëndetësor pa u pajisur me Lejen (licensën) e Ushtrimit të Profesionit nga Urdhri i Stomatologut
  - b. Të informojë Urdhërin e Stomatologut mbi masat administrative që janë marrë në inspektimet e ushtruara në institucionet e kujdesit shëndetësor

## **Neni 4** **Angazhimet e Urdhrit të Stomatologëve**

1. Urdhri i Stomatologëve të Shqipërisë merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:
  - a. T'i sigurojë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor informimin e domosdoshëm mbi mangësitë e konstatuara gjatë veprimtarisë monitoruese e kontrolluese si dhe bashkëpunimin e nevojshëm për ndreqjen e tyre
  - b. Të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tij në grupet e përbashkëta të inspektimeve me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor
  - c. Të informojë Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për ecurinë e procesit të zhvillimit të praktikës mjekësore nga ana e Stomatologëve dhe për procesin e testimit të tyre

## **Neni 5** **Ndryshimi i Memorandumit**

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

**Neni 6**  
**Afati i Memorandumit**

Ky memorandum lidhet për një afat të pacaktuar. Palët mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

**Neni 7**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

**Neni 8**  
**Hyrja në Fuqi**

Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 5 (pesë) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, 2 (dy) të tjerat pranë Urdhërit të Stomatologëve dhe 1 (një) në Ministrinë e Shëndetësisë.

**KRYEINSPEKTORI I ISHSH**



**PRESIDENTI I USSH**

**Z. NIKOLL DEDA**

